



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:197700

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06576541

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega Kaçanik, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Riza Livoreka, me sekretaren Juridike Azemine Berisha , në çështjen juridike, të paditësve R. A. nga fshati ... Komuna Ferizaj, me numër personal ..., I. L. nga fshati ...-Hani i Elezit, numër personal ..., S. R. , nga fshati ... Ferizaj, me numër personal ... dhe L. L. , nga fshati ... Hani i Elezit, të cilit me autorizim i përfaqëson L. N. Avokat Ferizaj, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për çështjen kontestuese shpërblim i pagës jubilarë, shujtën ditore, dhe pagën e 13-të, jashtë seancës gjyqësore, më datën 10.12.2024, ndërsa në të njëjtën ditë bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET pjesërisht si e bazuar, kërkesëpadia e paditësve, R. A. nga fshati ..., I. L. nga fshati ..., S. R. , nga fshati ... dhe L. L. , nga fshati ... Hani i Elezit dhe **DETYROHET** e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës-Ministria e Punëve të Brendshme- Policia e Kosovës, që paditësve, në emër të pagës së trembëdhjetë dhe diferencës për pagën jubilarë, për vitet 2018, 2019, 2020, dhe 2021 , t'ia paguaj edhe atë siç vijon:

- R. A. , shumën prej3,378.83€
- I. L. shumën prej3,063.64€
- S. R. shumën prej3,279,68€
- L. L. shumën prej.....3,020.75€

Gjithsejtë për pagesë shumë prej 12,742.90€

Shumë prej 12,742.90€, me kamatë prej 8 %, duke filluar nga 06.09.2021(data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën përfundimtare.

II REFUZOHET, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve, R. A. nga fshati ..., I. L. nga fshati ..., S. R. , nga fshati ... dhe L. L. , nga fshati ... Hani i Elezit,, mbi shumën e gjykuar edhe atë për shumën prej 4,936.71€, në emër të pagës së 13, për vitin 2022-2023 , SI E PA BAZUAR.

III.DETYROHEN paditësit qe në mënyrë solidare, kësaj gjykate, të ja paguajnë shumën prej 100.00,€ , në emër të taksës për padi, e cila pagesë do të bëhet, në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit.

IV. **Padia e** paditësve, F. K. nga Kaçaniku, I. B. , nga fshati ...-Ferizaj, I. B. Inga fshati ...- Kaçanik, G. K. , nga fshati ...Ferizaj, në emër të kompensimit të shujtave ditore pranohet E TËRHEQUR.

V. **DETYROHET**, e paditura qe paditësve, t'ia paguaj shumat si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumë prej 620,00€, të gjitha këto, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësit përmes të autorizuarës, me datën 06.09.2021, në Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik, kanë paraqitur padi, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, me të cilën kanë kërkuar, pagesën e pagës jubilarë, ushqimin dhe pagesën e pagës së 13-të.

E autorizuara, ka theksuar se këto detyrime, burojnë nga Udhëzimi Administrativ mbi marrëdhënie e punës në Polici nr. 02/2018, i datës 14.11.2018. Me nenin 29 par 1, të këtij udhëzimi, lidhur me të drejtën në pagë dhe shpërblime, është paraparë e drejta e shujtës ditore, për secilin të punësuar në policinë e Kosovës.

Me paragrafin 2, të këtij neni, është paraparë se: “personelit të policisë, të cilit kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilit nuk kanë qenë subjekt shqiptimi, të ndonjë mase

disiplinore brenda viti përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit”.

Ndërsa sipas paragrafit 5, të nenit 29 të UA nr.02/2018, është paraparë, se personeli policor që është në marrëdhënie të vazhdueshme pune, në Policinë e Kosovë, ju takon shpërblimi në vlerë prej 25%, të pagës mesatare për çdo 10 vite pune.

E autorizuar e paditësve, me parashtrësën e datës 26.01.2024, e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, për secilin paditës, dhe ka kërkuar pagesën e pagës për fund vit (pagën e 13-të), për vitet, 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 për disa paditës dhe diferencën në pagë jubilarë. Po ashtu pala paditëse, e ka tërhequr padinë në emër të kompensimit të shujtave ditore, ndërsa shumat e precizuara, i kërkuar edhe kamatën ligjore, që nga hyrja në fuqi e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 (data 14.11.2018), e deri në pagesën përfundimtare.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata me qëllim të përgatitjes së çështjes për shqyrtim dhe zgjidhjes sa më të shpejt të sajë konform neneve 387 par.1, 394, 395 dhe 396 të LPK-së, e ka nxjerr aktvendim më datë 29.09.2022, me të cilin e ka detyruar të paditurën për dhënien e përgjigjes në padi, në afat prej 15 ditëve dhe ti paraqes prapësimet procedurale, të deklarohet se a e pranon apo e konteston kërkesë padinë e paditësve.

Po ashtu me këtë aktvendim, gjykata e ka paralajmëruar të paditurin, se nëse në afatin e paraparë nuk paraqet përgjigje në padi do të merret aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë, nëse plotësohen kushtet nga neni 150.par 1 pika (a, b, dhe c) të LPK-së.

E paditura me datën 03.11.2022, në gjykatë e ka dorëzuar parashtrësën për përgjigje në padi, me të cilën e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të njëjtën ta refuzojë si të pa bazuar.

E paditura, i ka propozuar gjykatës që padinë ta hedhë poshtë si të pas afatshme, sepse nuk e ka zhvilluar procedurën interne, të paraparë me nenin 78 paragrafi1 të Ligjit Nr.03/L-212. Ka deklaruar se nuk është kontestues fakti, se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, duke u mbështetur në Vërtetimet e punësimit të lëshuara nga e paditura.

Po ashtu ka theksuar, se kërkesa e paditësve, është parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të punës, me të cilën dispozitë është paraparë se kërkesat parashkruhen, në afat prej 3

viteve, si dhe me dispozitën e nenit 341 të LMD-së. Po ashtu e ka kundërshtuar edhe kërkesën për pagesën e pagës së 13, për vitin 2022, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, me të cilin është shfuqizuar UA.nr. 02/2018, për mardhenjën e punës në Policinë e Kosovës.

Më tutje ka kundërshtuar edhe kërkesëpadinë e paditësit, për sa i përket kompensimit të pagës së 13-të, pasi që nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr. 07/L-041, mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-1125, neni 20 par 4, për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2017, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë e kësaj çdo veprim apo nismë, duke përfshirë edhe nenin 29 pika 2 të UA nr. 02/2018, për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare, nuk është i obligueshëm, përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore-financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata, duke vlerësuar provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, kundërshtimet e palës së paditur, me përgjigje në padi, me të cilat vërtetohet se pala e paditur e ka kundërshtuar padinë por nuk i ka kundërshtuar faktet kryesore të paraqitura me padi. Gjithashtu në bazë të provave, të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezultojnë, themelësia e pjesshme e kërkesëpadisë dhe gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet, për dhënien e aktgjykimit, pa shqyrtim kryesor, në përputhje me nenin 152 të LPK-së. Me këtë dispozitë thuhet se: Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt “kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”.

Pas analizimit të provave në tërësi dhe të së cilës veç e veç, si dhe të ndërlidhura si tërësi në mes veti, mbi bazën e bindjes se lirë, në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së. Gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko civile vërtetoi këtë gjendje faktike

Paditësit, janë në marrëdhënie pune tek e paditura, kjo e drejt në kompensim e pagës së 13 ju takon. E paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, të cilin ka pasur për obligim ta kompensoj dhe paditësve nuk iu takon e drejta në kompensimin e pagës së 13-të për vitin 2022.

a) Se paditësit janë të punësuar tek e paditura, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar, nga provat të cilat gjinden në shkresat edhe atë: kontratat e punës, vërtetimin mbi punësimin e paditësve dhe listat të cilat i janë bashkangjitur precizimit të padisë (fakt i cili nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse).

b) E paditura ka pasur për detyrim, qe paditësve të ua paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, kjo pagesë paditësve ju takon në bazë të Udhëzimeve Administrativ 02/2018, i datës 14.11.2018 dhe 01/2021, i datës 29.09.2021, mbi marrëdhënien e punës në Policin e Kosovës.

c) E paditura nuk e ka përmbushur detyrimin, të cilin e ka pasur për detyrim ta përmbush, këtë fakt gjykata e vërtetoi me vetë faktin se paditësit kanë paraqitur padi, me të cilën kanë kërkuar, pagesën e pagës së pa paguar nga e paditura.

Gjykata pas analizimit të thënieve në padi, provave të bashkangjitura, përgjigjes në padi gjeti se kërkesëpadija e paditësve është pjesërisht e bazuar dhe të njëjtën e miratoi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e miratoi kërkesëpadinë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës, e cila dispozitë e përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”. Po ashtu nenin 44, paragrafi 2 i Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”, ndërsa nenin 55, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetës edhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 ku përcaktohet se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr. 02/2018, përcaktohet se 2. “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit.”

Në rastin konkret, gjykata vlerëson se e paditura me asnjë provë nuk ka dëshmuar për ndonjërin nga paditësit zhvillimin e ndonjë procedure disiplinore, me ç, rast gjykata e merr si të mirëqenë faktin, se paditësit gjatë kësaj periudhe kohore, kanë pasur vlerësim të kënaqshëm dhe nuk kanë qenë subjekt i ndonjë mase disiplinore.

Ashtu që, gjykata vlerëson se paditësit, kanë të drejtë që të kërkojnë pagën e 13-të, duke u mbështetur edhe në dispozitat nën-ligjore, respektivisht Udhëzimin Administrativ, të cekur më lartë, i cili në mënyrë të qartë e përcakton të drejtën e paditësve për të marrë shumat e cekura në emër të pagës së 13-të, të përshkruara në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 dhe UA nr. 01/2021, mbi Marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, për kërkesën e aprovuar të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13-të respektivisht për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Gjithashtu me mendimin juridik nr. 213/2023 te datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme te Kosovës, ne pikën II, theksohet se “ne kontestet nga marrëdhëniet e punës, lidhur me kërkesat për shpërblim të pagës së 13-të, për personelin e policisë, të cilat kërkesa janë paraqitur pas datës 14.11.2018, ne bazë të nenit 29 par. 2 te Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 14.11.2018, dhe në bazë të nenit 30 par. 2 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili ka hyrë në fuqi më datë 29.09.2021, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019, 2020 dhe 2021.

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e kompensimit për shpërblimin e pagës së fund viteve 2018, 2019, 2020 dhe 2021, gjykata mori për bazë kartelat e nëpunësit për muajin dhjetor për të gjitha vitet, vërtetimin e punësimit, të vlerësuar si më lart, për paditësit dhe listat e pagave të bashkangjitura me precizimin e kërkesëpadisë.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës se palës paditëse, e ka caktuar edhe lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, duke filluar nga 06.05.2021, e deri ne pagesën përfundimtare, në bazë të nenit 382 par 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme te Kosovës nr. 256/2020, i datës 01.12.2020, për kamatat.

Gjykata e refuzoi, pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditësve, mbi shumën e gjykuar edhe atë për shumën prej 4,936.71€, në emër të shpërblimit të një page mujore ekuivalente, me

pagën e rregullt mujore për vitin 2022 dhe 2023, të kërkuar nga ana e paditësve, duke u bazuar në mendimin juridik nr. 213/2023, të datës 09.10.2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës, në pikën II, theksohet se “ne kontestet nga marrëdhëniet e punës lidhur me kërkesat për shpërblim të pagës së 13-të, për personelin e policisë, të njëjtit kanë të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021”.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: “Po qe se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.” Edhe me dispozitën e nenit 398 të LPK-se, parashihet shprehimisht se gjykata mund të jap aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes, nëse pas marrjes së përgjigjes në padi, konstaton se në mes të palëve nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante. Meqenëse janë plotësuar kushtet edhe atë: e paditura është përgjigjur në padi pastaj pala e paditur ka theksuar se nuk ka mjete për të paguar këtë detyrim nuk e ka pohuar e as mohuar kërkesëpadinë e paditësit dhe nuk ekziston pengesa tjera për dhënien e këtij aktgjykimi.

Gjykata me rastin e vendosjes ka marrë për baze nenin 10 par.1 të LPK-së, me këtë dispozitë është paraparë se “ne rast të fillimit të procedurës gjyqësore civile atëherë është obligim i gjykatës por edhe i palëve që procesi të zhvillohet në mënyrë sa më efektive dhe me shpenzime sa më të vogla që është menduar”. Pra, qëllimi i kësaj dispozite është që procesi të jetë efikas i shpejtë dhe i lirë. Ky detyrim se pari i takon gjykatës dhe palëve pjesëmarrëse në këtë proces.

Gjykata, para se të vendos në mënyrë meritore, në këtë çështje kontestimore, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 398 i LPK-së, me të cilin përcaktohet se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera, për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seance gjyqësore, mund ta japë aktgjykimin, me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, si dhe nenin 399 të LPK-së, ku parashihet se: Kur gjykata pasi të arrijë përgjigje në padi konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia, dhe ka konstatuar se ekzistojnë kushtet ligjore për marrjen e këtij Aktgjykimi, pasi që faktet vendimtare nuk janë kontestuar nga ana e të paditurës, respektivisht nuk është kontestuar gjendja faktike, se paditësi është në

marrëdhënie pune tek e paditura, nuk është as kontestuese fakti se i njëjti është vlerësuar gjatë vitit 2018,2019 dhe 2020, me performancës tejet adekuate domethënë të kënaqshme.

Gjykata padinë e paditësve, R. A. nga fshati ..., I. L. nga fshati ..., S. R. , nga fshati ... dhe L. L. , nga fshati ... Hani i Elezit, në emër të kompensimit të shujtave ditore, e pranoi të tërhequr sepse e autorizuar e paditësve, me parashtrësën mbi precizimin e padisë, e ka tërhequr padinë sa i përket shujtave ditore.

Gjykata i analizoi theksimet e palës paditëse, e cila i ka propozuar gjykatës, që kërkesëpadinë e paditësve ta miratoj në tersi si të bazuar. Këtyre theksimeve, u a fali pjesërisht besimin, sepse kërkesëpadia e paditësve, ishte e bazuar në Ligjin e punës dhe në Udhëzimin Administrative me nr. 02/2018.

Gjykata i analizoi pretendimet e palë së paditur, të paraqitura me parashtrësën e datës 05.02.2024, me të cilën i ka propozuar gjykatës, qe padinë ta hedhë poshtë si të pas afatshme, sepse nuk e ka zhvilluar procedurën interne, e paraparë me nenin 78 paragrafi1 të Ligjit Nr.03/L-212. Po ashtu edhe pretendimin se kërkesa e paditësve, është parashkruar konform nenit 87 të Ligjit të punës, si dhe dispozitës së nenit 341 të LMD-së. Po ashtu e ka kundërshtuar edhe kërkesën për pagesën e pagës së 13 , për vitin 2022, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.01/2021, me të cilin është shfuqizuar UA.nr. 02/2018, për mardhenjën e punës në Policin e Kosovës.

Gjykata e analizoi edhe pretendimin, se padia e paditësve është e pas afatshme, sepse paditësit nuk e kanë zhvilluar procedurën e paraparë me neni 78 të Ligjit të punës Nr. 03/1/212. Këto pretendime gjykata i refuzoi, si të pa bazuara, sepse kjo dispozitë e rregullon, çështjen e kthimit të punëtorit në punë, a në rastin konkret kemi të bëjmë me pagesën e pagave të pa paguara.

Po ashtu gjykata ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve, nuk është parashkruar, as sipas nenit 87 të Ligjit të punës, e as sipas nenit 341 të LMD-së. Paditësit padinë, e kanë paraqitur në afatin e paraparë ligjor dhe kjo kërkesë nuk është parashkruar .

Gjykata po ashtu e analizoi edhe pretendimi, e palës së paditur, se njëjta s'ka mjete financiare për ta bërë pagesën e këtyre kërkesave. Këto pretendime gjykata nuk i mori për bazë me rastin e vendosjes, sepse pala e paditur vetëm e ka theksuar këtë fakt, se nuk ka mjete për

pagesën e këtyre kërkesave, këtë pretendim nuk e ka vërtetuar me asnjë provë, siçë janë mungesa e mjeteve për realizimin e projekteve konkrete, për shkak të mungesës së mjeteve etj.

Gjykata i obligoi paditësit që në mënyrë solidare, kësaj gjykate, të ja paguaj shumen prej 100.00.€, në emër të taksës për padi, sepse pala paditëse nuk e ka paguar taksen me rastin e dorëzimit të padisë në gjykate, ashtu siç është përcaktuar me nenin 253 par. 4 të LPK-se, ku pala paditëse ka pasur detyrim që padisë, të ia bashkëngjis dëshminë mbi pagesën e taksës gjyqësore, konform Udhëzimit Administrative për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017.

Gjykata obligoi palën e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës kontestimore, konform nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-së, sipas të cilave paditësit i pranohen shpenzimet e procedurës kontestimore 724,00€, edhe atë: në emër të përpilimit të padisë, shumën prej 624,00€ dhe shumën prej 100.00€, në emër të taksës për padi.

Nga se u tha me lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr. 2021:197701 datë 10.12.2024

Gjyqtari:

Riza Livoreka

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme.

Dërguar me datën 10.12.2024

Paditësve 1x1

Të paditurës 1x1